



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE

Adresa: Sheshi "4 Heronjtë", Tel: 033 421-215; Fax 033 421-201; E-mail: info@vlora.gov.al

Nr. 5294 prot

Vlore me 13.11 2015

Projekt Vendim
Nr. _____ Dt. _____ 2015

"Per miratimin e perfaqesuesit te Bashkise Vlore ne Asamblene e Aksionereve te sh.a Ujesjellesit Vlore"

Keshilli i Bashkise Vlore ne mbledhjen e dates _____, bazuar ne ligjin nr. 8652 dt.31/07/2000 " Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore " i ndryshuar neni 8 dhe 32, ligji nr.9091 dt.14.04.2008 " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare ", neni 135 e ne vijmin, V.K.M nr.678 dt.03.07.2007 " Per nje shtese ne V.K.M nr.271 dt.09.05.1998 " Per miratimin e statutit tip te shoqerive anonime shteterore ", te V.K.M nr.510 dt.10.06.2015 " Per miratimin e procedurave per transferimin e te drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve te trupezuara dhe te patrupezuara te arkivave dhe cdo dokumentacioni tjeter zyrtar ne njesite e qeverisjes vendore te prekura nga riorganizimi administrativo territorial ", udhezimit nr.965 dt.11.12.2007 te Ministrit te Ekonomise Tregetise dhe Energjitikes "Per zbatimin e Vendimit te Keshillit te Ministrave, per transferimin e aksioneve te shoqerive te Ujesjelles Kanalizimeve ne njesite e qeverisjes vendore".

Vendosi:

1. Te autorizojë Z.Dritan Leli si perfaqesues te Bashkise Vlore ne Asamblene e Aksionereve te sh.a Ujesjelles Kanalizime Vlore
2. Vendimi i Keshillit te Bashkise nr.14 dt.08.09.2011 si dhe cdo vendim tjeter qe bie ne kundërshtim me kete vendim, revokohet.
3. Ky vendim hyn ne fuqi sipas ligjit nr. 8652, dt.31.07.2000 "Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", i ndryshuar neni 33 pika 6.

KRYETARI

Dritan LELI 2015





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE

Adresa: Sheshi "4 Heronjtë", Tel: 033 421-215; Fax 033 421-201; E-mail: info@bashkiavlore.org

Nr. 9294 Prot.

Vlore me 13/11 2015

RELACION

Mbi projekt- vendimin " Per caktimin e perfaqesuesit te Bashkise Vlore ne Asamblene e Aksionereve te sh.a Ujesjelles Kanalizime Vlore ".

Te nderuar Keshilltare !

Me vendimin nr.14 dt.08.09.2011 Keshilli i Bashkise Vlore ka autorizuar ish- Kryetarin e Bashkise te perfaqesoj Bashkine Vlore, ne Asamblene e Aksionereve te sh.a Ujesjelles Kanalizime Vlore. Vlersojme se ndryshimet qe ndodhen pas zgjedhjeve te dt.26.06.2015 per organet e qeverisjes vendore ne drejtimin e Bashkise Vlore duhet te reflektohen edhe ne sh.a Ujesjelles kanalizime Vlore.

Keto ndryshime behen te domosdoshme vecanerisht ne zbatim te ligjit nr.115/2014 dt.31.07.2014 "Per ndarjen administrativo territoriale te njesive te qeverisjes vendore, ne Republiken e Shqiperise si dhe te V.K.M nr.510 dt.10.06.2015 " Per miratimin e procedurave per transferimin e te drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve te trupezuara dhe te patrupezuara te arkivave dhe cdo dokumentacioni tjeter zyrtar ne njesite e qeverisjes vendore te prekura nga riorganizimi administrativo territorial ", te cilat ndryshojne edhe menyren e organizimit dhe funksionimit te kesaj shoqerie. Keto ndryshime krahas te tjerave reflektojne dhe perberjen e aksioneve, pasi aksionet e ish-komunave Qender Vlore dhe Shushice, aktualisht i transferohen Bashkise Vlore , nderkohe qe aksionet e ish -komunave Kote dhe Armen i transferohen Bashkise Selenice. Keto ndryshime kerkojne domosdoshmerisht vendimarrjen perkatese te Asamblese se Aksionereve.

Nisur nga fakti se Kryetari i Bashkise eshte organi ekzekutiv i njesive te qeverisjes vendore i cili pergjigjet per te gjitha sherbimet qe duhet te realizoje Bashkia per qytetaret, vlersojme se perfaqesues i Bashkise ne Asamblene e Aksionereve duhet te jete Kryetari i Bashkise. Autorizimi i Kryetarit te Bashkise, ne Asamblene e Aksionereve krahas te tjerave krijon mundesine e nje vendimarrje te shpejte si dhe koordinim me te efektshem te punes se administrates se Bashkise, me administraten e sh.a Ujesjelles Kanalizime per rritjen e performances se shoqerise.

Nga sa me larte vlersojme se Keshilli i Bashkise duhet te miratoje kete projekt-vendim , i cili mundeson vazhdimin e procedurave te metejshme ligjore , per organizimin dhe funksionimin e sh.a Ujesjelles kanalizime Vlore.

Duke ju falenderuar per bashkepunimin !

KRYETAR

Dritan LELI

